



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 23.05.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:14 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Antuen Skëndaj, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 8. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Marjana Papa, OSCE.*
- 10. Arman Sokoli, KSHH.*
- 11. Gregor Borgoëski, EURALIUS.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 14. Erjon Fejzulla, USAID.*
- 15. Artan Spahiu, Kryetar i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016.*
- 16. Klara Kodra, Q.Evropiane.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë të Gjyqësor të datës 23 maj 2019.

Prezent janë te gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni vënë në dijeni me rendin e ditës, sot në rendin e ditës janë dy çështje. Çështja e parë lidhet me: Për shqyrtimin e projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. Projekt-akt i cili është përgatitur nga Komision i Zhvillimit të Karrierës.

Ndërkohë, si pikë të dytë të rendit të ditës, sikurse ju kisha informuar, kisha vënë çështje “Të tjera”, por për saktësim, çështja e dytë e rendit të ditës do të jetë shqyrtimi i projektvendimit “Për disa ndryshime, anulimin e vendimit nr. 74, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ku ato ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të përhershëm”.

Po! Anulimin pjesërisht.

Atëherë duke kaluar tek çështja e parë e ditës, unë jam me thënë të vërtetën shumë e lumtur që në këtë mbledhje ne do të shqyrtojmë një nga projekt-aktet më të rëndësishme, e cila është një nga risitë dhe standardet që reforma ka realizuar, që është rregullorja për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për çdo kandidat për gjyqtar apo person që do të përfshihet në sistemin gjyqësor.

Sikurse jeni në dijeni, kjo është një rregullore e cila do të miratojë rregulla shumë të hollësishme lidhur me procedurat për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për emërimin dhe ngritjen në detyrë të kandidatëve gjyqtarë, për riemërimin e kandidatëve ish-gjyqtarë dhe për emërimin e kandidatëve gjyqtarë dhe jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë si dhe për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve.

Ndaj me këtë vendim mendoj që ne i hapim rrugë nisjes së procesit të rekrutimit të të gjithë kandidatëve për gjyqtarë duke shpallur dhe vendet vakante për gjyqtarët në disa gjykata të cilat aktualisht kanë mungesë të theksuar të gjyqtarëve dhe duke shpresuar në plotësimin e organikave të tyre. I hapim rrugë procesit të emërimit të magistratëve të

rinj të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 por edhe atyre që do te përfundojnë këtë vit akademik shkollën.

Ky vendim është një vendim i cili do i hapë rrugën dhe emërimit të kandidatëve gjyqtarë dhe jo-gjyqtarë për Gjykatën e Lartë duke ndikuar drejtpërdrejtë në reduktimin e volumit të madh të çështjeve që ndodhen pranë kësaj gjykate. Qëllimi i këtij vendimi është realizimi i procedurave për verifikimin e kandidatëve duke u bazuar në meritat e tyre, në procesin e rregullt ligjor si dhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative. Ajo që unë dua të theksoj është që grupi i punës, Komisioni përkatës që ka draftuar këtë projekt-akt, ka punuar në mënyrë shumë të ngushtë me misionet dhe veçanërisht me misionin e EURALIUS, gjë për të cilën unë e përgëzoj për punën dhe ndihmesën që na kanë dhënë në hartimin e këtij projekt-akti.

Për më shumë detaje, unë do të doja t'ia jepja fjalën kryetarit të Komisionit propozues të projekt-aktit, zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë siç tha dhe Kryetarja, sot jemi para diskutimit dhe miratimit të një prej akteve më të rëndësishme rregullatore që duhet të miratojë Këshilli i Lartë Gjyqësor, që lidhet drejtpërdrejtë me rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës si dhe për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë. Nuk është akti i vetëm që do duhet për të gjithë këtë proces. Më vonë do duhet të miratojmë edhe një akt tjetër që ka të bëjë me vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve, që të dy këto akte në mënyrë komplementare mund të japin rezultatin që ligji parashikon, pra për të gjithë proceset që ne duhet të realizojmë.

Ky akt është në ushtrim të përgjegjësive që Kushtetuta dhe ligjet organike kanë ngarkuar Këshillin e Lartë Gjyqësor. Qëllimi i vendimit është të përcaktojë rregulla të hollësishme për të gjithë procedurat që duhet të ndjekë Këshilli, për të gjitha proceset, si për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë ashtu edhe për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve apo dhe për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë.

Në kreun e 1-rë përcaktohet qëllimi dhe objekti i vendimit.

Në kreun e 2-të përcaktohen subjektet e vendimit, që janë shtatë të tillë, referuar ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në kreun 3 referohet kuadri ligjor mbi të cilin është mbështetur hartimi i këtij vendimi, por që aktet ligjore, këto që janë të zbatueshme, në çdo rast sipas procedurave që duhet të ndjekë Këshilli rast pas rasti.

Në kreun e 5-të (*lapsus, bëhet fjalë për kreun IV*) përcaktohen përkufizimet që janë terma të përdorur në projektvendim për të lehtësuar qoftë kuptimin ashtu dhe për të qenë më i lehtësuar akti në pikëpamje të teknikës legislative.

Në kreun e 5-të përcaktohen rregulla të përgjithshme të procedurës së verifikimit. Ky kre është ndarë në disa seksione: Seksioni A bën fjalë për fillimin dhe fazat e procedurës së verifikimit; Seksioni B bën fjalë për të drejtat e kandidatit; Seksioni C bën fjalë për afatet dhe llogaritjen e tyre dhe; Seksioni Ç bën fjalë për njoftime. Në të gjitha seksionet ka përcaktime të hollësishme për gjithçka që ka marrë përsipër të rregullojë vendimi për të gjitha llojet e procedurave konkrete.

Në kreun e 6-të përcaktohen fazat e procedurës së verifikimit të kandidatëve. Janë katër faza dhe sipas këtyre katër fazave janë katër seksione. Seksioni A janë veprimet procedurale paraprake të relatorit të çështjes dhe përjashtimi i tij; Seksioni B janë veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes; Seksioni C është shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit të verifikimit nga Komisioni dhe; Seksioni Ç është shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit të verifikimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në përfundim të procedurës së verifikimit, Këshilli duhet të dali me vendimin e verifikimit. Kjo është përcaktuar në kreun e tetë, ku parashikohet edhe e drejta e ankimit të kandidatëve. Kjo është në kreun 7.

Në seksionin 8 është publikimi i aktit të procedurës së verifikimit pra vendimet e Këshillit të Lartë në lidhje me verifikimin e kandidaturave që duhet të botohen në faqen zyrtare të Këshillit.

Më tej në kreun 9 janë rregullat në lidhje me procedura të veçanta për verifikimin e kandidatëve, pra rregulla të mëtejshme, përtej atyre të rregullave të përgjithshme, ato që kanë të bëjnë më ekzaktesisht me verifikimin e pasurisë së kandidatit që është në seksionin A; Ndërsa në seksionin B janë rregullat në lidhje me verifikim e figurës dhe integritetit të kandidatit; Më tej në këtë kre në seksionin C janë rregullat në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit për në Gjykatat e Posaçme për gjykimin e

veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, kategori kjo e magjistratit që ka rregullime ligjore të ndryshme nga kategoria tjetër e magjistratëve që u nënshtrohen procedurave të zhvillimit të karrierës; Më tej në seksionin Ç ka rregulla të posaçme lidhur me verifikimin dhe kushtet e tjera ligjore të kandidimit.

Dhe në përfundim, në kreun e 10-të ka dispozitat kalimtare dhe të fundit ku në seksionin A janë rregullat në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit për Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; Në seksionin B janë rregulla të posaçme për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84 të vitit 2016; Në seksionin C janë rregulla të posaçme për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve ish-gjyqtarë sipas nenit 166 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Në fund, në seksionin Ç janë dhe rregullat kalimtare për mbylljen e procedurave të verifikimit, ku në finale përcaktohet se procedurat e vlerësimit dhe pikëzimit sikundër dhe ajo e renditjes së kandidatit do të rregullohet me një akt të veçantë, që është akti që duhet të miratojmë në vijim të aktit që kemi sot për diskutim dhe miratim.

Aktin ne e kemi diskutuar dhe paraprakisht mes njëri tjetrit. Janë reflektuar nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës çdo sugjerim që anëtarët kanë pasur. Nëse ka pasur ndonjë pyetje apo diskutim, ne mund t’i ofrojmë shpjegime për sa do të na kërkohet. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Falënderoj shumë Komisionin tuaj për këtë projekt-akt që keni bërë kaq voluminoz.

Nëse një nga anëtarët ka komente ose sugjerime lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit.

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt edhe unë e falënderoj Komisionin e Zhvillimit të Karrierës. Ka bërë vërtetë një punë profesionale dhe të lodhshme.

Është një akt shumë i rëndësishëm, mbartur shumë probleme dhe e vlerësoj punën e tyre.

Por ndërkohë desha vetëm të saktësoj nja dy gjëra. Mbase s'kam marrë pjesë në këto bisedat e fundit. Unë jam ndalur tek pjesa V “Përkufizime” (*bëhet fjalë për kreun IV*), pika e 7-të tek kandidatët ish-gjyqtarë. Tek e lexoj, nuk me bie në sy fakti që, ose nuk më del më tepër, fakti i ndalimit që ka për ato kandidatë ish-gjyqtarë që nuk kanë futur letrat në veting sepse në bazë të ligjit 84/2016 ka pasur një afat ku dhe ato që nuk janë në detyrë... dhe normalisht këtë e lidh pastaj edhe me 179 pika /b/ të Kushtetutës që e lidh detyrimin e këtyre me këtë ndalimin. Dhe tek po kërkoja në fakt edhe tek pjesa hyrëse referenca mbi bazën ligjore por dhe tek kuadri ligjor, nuk përmendet 179, çka do të thotë që në lexim të drejtpërdrejtë të këtij teksti, krijohet ideja sikur u lejohet të gjithë ish-gjyqtarëve apo prokurorëve që të fusin letrat, ndërkohë që kam përshtypjen që duhet të bëhet për ato persona që tashmë i kanë futur letrat, pra kanë hyrë në procesin e vetingut. –Kjo një. Apo pres përgjigje?

Naureda Llagami: Zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë tek pika 7 e kreut IV ku janë përkufizimet, përcaktohen dhe përkufizimet për kandidatët ish-gjyqtarë. Përkufizimi këtu është motamo sipas nenit 36 të ligjit “Për Statusin” por dhe nenit 166 tek dispozitat kalimtare të këtij ligji. Pra janë dy kategori gjyqtarësh sipas ligjit të Statusit njëra që rregullohet për të gjithë ish-gjyqtarët në një situatë normale, ndërkohë tek dispozitat kalimtare ligjvënësi ka marrë përsipër të përcaktojë në një mënyrë jo të njëjtë kategorinë e ish-gjyqtarëve që mund të emërohen në situatën aktuale. Në ligjin e Statusit nuk ka ndonjë kufizim për periudhën kohore brenda të cilës ata duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërkohë që nuk gjendet e njëjta gjë tek ligji nr.84 i vitit 2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këtë mospërputhje nuk mund ta rregullojmë dot. Kemi marrë përsipër të përcaktojmë të gjithë rregullat sipas ligjit të Statusit për të cilën ligji na ngarkon të përcaktojmë rregulla më të hollësishme.

Një nga sugjerimet që ne kemi sugjeruar që t'i behet Kuvendit të Shqipërisë është që të përputhë, të harmonizojë këtë mënyrë të ndryshme mes nenit 166 ligjit “Për statusin” me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku ndërsa në ligjin e Statusit nuk përcaktohet një afat kohor që

kufizon kandidimin, tek ligji për Rivlerësimin ka një periudhë tremujore nga hyrja në fuqi e ligjit për të kandiduar ish-gjyqtarët apo ish-prokurorët.

Gjithsesi ne e kemi konsideruar ligjin e Statusit si ligjin kryesor dhe përcaktimet e tij mbi të cilin ne duhet të përcaktonim rregulla të hollësishme.

Maksim Qoku: Megjithatë, për të gjithë ne dhe për kolegët e tjerë, hajde ta gjykojmë. Kam idenë që 179/b-ja përcakton detyrimin e ish-gjyqtarëve që ta bëjnë këtë dokumentacion dhe ta fusin për të kaluar në veting, çka do të thotë, si një nen detyrues mbi ligjin, mendoj që i duhesh dhënë prioritet, pastaj në referim të ligjit të posaçëm 84/2016 duke qenë që kishte një afat, unë personalisht, por të gjithë ne i njohim gjyqtarët që nuk e kanë mundur ta kapin këtë afat dhe nuk i kanë futur dot letrat. Çka do të thotë, mënyra sesi e lexojmë tashmë ne këtë vendim, mundet që ato nuk e kaluan vetingun për faktin që s'e kapën afatin por që të fusnin kërkesat për t'u konsideruar ish-gjyqtarë. Ky lloj handikapi nuk mund të shkojë kundër frymës së ligjit të posaçëm për vetingu, aq më tepër kundër Kushtetutës, megjithatë e debatojmë.

Unë propozoj që të përmendet 179/b në bazën ligjore minimalja apo dhe të thuhet tek pjesa e kandidatëve ish-gjyqtarë, që flitet për ato që kanë paraqitur letrat për t'iu nënshtruar procesit të vetingut, ish-gjyqtarë.

Ilir Toska: Në nenin 179/b, Kushtetuta nuk ka përcaktuar një afat, afati është përcaktuar vetëm tek ligji i posaçëm për rivlerësimin kalimtar. Nuk ka neni 179 një afat. Lejon të riemërohen ish-gjyqtarët sipas kësaj dispozite por nuk ka një afat brenda të cilit ata duhet të kandidojnë.

Maksim Qoku: Të thashë 179/b përcakton faktin që sikurse gjyqtarët dhe prokurorët dhe ish-gjyqtarët do bëjnë të njëjtën gjë, këtë bën, por pjesën tjetër e përcakton 84.

Ilir Toska: Proces rivlerësimi nuk do të thotë që ka një afat brenda të cilit ata duhet të konkurrojnë. Afati tremujor është i përcaktuar vetëm tek ligji i posaçëm për rivlerësimin. Nuk ka në Kushtetutë afat. Kushtetuta lejon në këtë kategori që të përfshihen përsëri në sistemin gjyqësor, Ligji i Statusit nuk ka kufizim tek neni 166.

Maksim Qoku: Okej, e kam parasysh.

Atë kam ide dhe unë, që nuk mundet që ... të parashikohet te ligji i Statusit po për derisa një ligj tjetër i ka, dhe në këtë procedurë është prioritare – mendimi im - ne duhet ta kishim parasysh.

Ilir Toska: Fakti që duhet të kalojnë procesin e rivlerësimit është përcaktuar edhe në rregullore, që edhe ish-gjyqtarët sipas nenit 166 të dispozitave kalimtare duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit.

Maksim Qoku: Jo! Po ideja ime është këtu që, ato që e kanë humbur këtë afat, për mua nuk duhet të pranohen me. Kjo është logjika. Sepse ato e kishin një afat për të cilin, arsyet e tyre... Por fakti që është afat, për mua është prekluziv, nuk ka më mundësi të bësh një gjë të tillë. Ne nuk mund të hapim më dyert për çdo lloj ish-gjyqtari, kjo është logjika. E mendojmë.

Ilir Toska: Duhet të këtë një afat brenda të cilit duhet të kandidojnë, se që duhet t'i nënshtrohen vetingut, do t'i nënshtrohen. Maksi ngre problemin që ata duhet ta kishin bërë tashmë.

Nuk mund ta bëjnë dot pas tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Ky është problemi.

Ligji i Statusit nuk ka përcaktuar afat për këtë kategori, tek ligji, ndërsa tek një ligj tjetër, tek ligji për rivlerësimin kalimtar ka përcaktuar për kategorinë e ish-gjyqtarëve një afat tremujor nga hyrja në fuqi që mund të aplikojnë.

Brunilda Kadi: Që do të thotë që çdo ish-gjyqtar do të kalojë se s'bën vetingun.

Maksim Qoku: Patjetër!

Ilir Toska: Fakti që do t'i nënshtrohet vetingut është i qartë. Duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit gjithë kategoria. Fakti që po ngre Maksi nuk është që do i nënshtrohen apo jo procesit të rivlerësimit, por a duhet të ndalojmë çdo kandidim pas tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit për rivlerësimin kalimtar.

Brunilda Kadi: Më fal Ilir!

Kur thua që do t'i kalojnë procesin e rivlerësimit, se tani jemi mësuar edhe me këtë termin popullor 'veting', pra çdo ish-gjyqtar që do kandidojë, duhet të ketë kaluar patjetër vetingun. Vetingun nga organet e vetingut.

Ilir Toska: Po pra, atëherë jam duke ju thënë që, emërimi sipas ligjit të rivlerësimit kalimtar e bëjnë organet e rivlerësimit kalimtar.

Do më dëgjoni?

Emërimin e ish-gjyqtarëve që aplikojnë për të hyrë në sistem, referuar ligjin për rivlerësimin kalimtar, e bëjnë institucionet e rivlerësimit kalimtar. Ne bëjmë caktimin e tyre në pozicione. I gjithë ngërçi që ngre Maksi është: A mundet një ish-gjyqtar që përfshihet sipas klasifikimeve të nenit 166 ligjit për Statusin, të aplikojë për të hyrë në sistem - jo për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit - a mund të aplikojë sot? A mund të hyjë në proces rivlerësimi? Sepse ligji i rivlerësimit ka venë një afat tremujor, ndërkohë që ligji i statusit nuk ka venë afat, ka thënë mund të aplikojnë kjo kategori për të hyrë në sistem. Jo se nuk duhet t'i nënshtrohen rivlerësimit.

Brunilda Kadi: Domethënë ata aplikojnë, por në momentin që aplikojnë dhe s'kanë kaluar vetingun, skualifikohen. Kjo është ideja e rregullores.

Ilir Toska: Nuk i nënshtrohet rivlerësimit dhe nëse kalojnë atje, marrin aktin e emërimit dhe ne bëjmë thjesht caktimin.

Brunilda Kadi: Okej! Që s'është objekt i yni.

Maksim Qoku: Okej. Nejse, e gjykojmë. Thjesht e kisha kapur si...

Brikena Ukperaj: Ideja është që, dakord aktualisht që janë në funksion organet që bëjnë procesin e rivlerësimit sepse kjo rregullore është afatgjatë. Do të vijë një moment që për shembull pas 5 vjetësh një ish-gjyqtar do bëjë kërkesë për t'u rekrutuar për t'u emëruar gjyqtar. Përbën pengesë kjo për faktin që... sepse ligji nuk e ndalon. Atëherë ky do t'i nënshtrohet të gjitha rregullave si çdo gjyqtar tjetër. Do të bëhet procesi i verifikimit të pasurisë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Ilir Toska: Atëherë, për sa kohë do të ekzistojnë institucionet e rivlerësimit, kjo kategori ish-gjyqtarësh që janë tek neni 166, mund të përfshihen në sistem. Duhet të dalloni që kategoria e ish-gjyqtarëve sipas nenit 166 të ligjit të statusit nuk është motamo e njëjtë me kategorinë e ish-gjyqtarëve që konsideron ligji në mënyrë permanente që përcaktohet në neni 36, pra ish-gjyqtarët sipas nenit 166 do të mund të hynë në sistem sa kohë janë institucionet e rivlerësimit dhe do mund të kalojnë procesin e rivlerësimit. Pra ish-gjyqtarët sipas nenit 166.

Te tjerët që kanë mbaruar shkollën dhe ka disa kritere të tjera ligji tek neni 36 është një kategori tjetër që nuk ka të bëjë fare me kategorinë e ish-gjyqtarëve sipas nenit

166. Pra brenda të njëjtës kategori janë dy nënkategori të ndryshme, nënkategoria e ish-gjyqtarëve sipas nenit 166 do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, për të hyrë në sistem.

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër?

Maksim Qoku: Nejse, unë them që do lëmë ndonjë ekuivok me këtë.

Unë propozova pra. Thashë të përmendet në bazë ligjore 179/b, sepse referon tek 84 për afatin, dhe natyrisht mund ta themi dhe tek termi që ato që janë ose që duhet të ishin nënshtuar vetingut deri në afatin që është 31.12.2017 (në janar), afati ligjor.

Megjithatë, edhe diçka tjetër të lutem Ilir.

Tek pjesa e dytë po e kësaj është përdorur termi 'periudha tranzitore' dhe më tepër nuk e di a do mund ta interpretonim tek pjesa e termave 'periudhë tranzitore', çfarë do të nënkuptojmë, tek pika 7, por thotë 'përjashtimisht për periudhën tranzitore'.

Ilir Toska: Pra pyetja që më bëri zoti Qoku, është përcaktuar tek seksioni C, në faqen 24, pika e parë, ku përcaktohet se gjatë periudhës së funksionimit të Komisionit të Pavarur të kualifikimit që korrespondon me periudhën tranzitore.

Maksim Qoku: Nejse, sugjerimi im do ishte që ta sqaronim tek termat, pra komision, relator, kandidat, por gjithsesi nëse ju mendoni që kjo pikë e sqaron. Okej! S'kam gjë tjetër.

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër?

Alban Toro: Të themi germën /h/, po në faqen 24, për të hequr atë merakun e ri integritit të këtyre gjyqtarëve, sipas nenit 166. Kandidatët ish-gjyqtarë që sipas nenit 166, të ligjit "Për statusin", të cilët nuk janë kualifikuar për emërim me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim nuk pranohen të kandidojnë për t'u emëruar dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit. Që do të thotë që i është mbyllur porta përfundimisht.

Naureda Llagami: Besoj që kjo u qartësua tani, që nuk është se neve po ndërhyjmë tek pjesa e ligjit "Për rivlerësimin", thjesht ne kemi bërë referim për pjesën e ligjit të statusit.

Nëse kemi ndonjë sugjerim konkret tjetër?

Atëherë kalojmë në votim projektvendimin e propozuar nga Komisioni sipas propozimit të Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin lidhur me procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës i zhvillimit të karrierës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 23.05.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Të tjera. - Shqyrtimi i projektvendimit “Për anulimin pjesërisht të vendimit nr. 74, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:14 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Antuen Skëndaj, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Marjana Papa, OSCE.*
10. *Arman Sokoli, KSHH.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
14. *Erjon Fejzulla, USAID.*
15. *Artan Spahiu, Kryetar i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016.*
16. *Klara Kodra, Q.Evropiane.*

RENDI I DITËS:

2. Të tjera - Shqyrtimi i projektvendimit “Për anulimin pjesërisht të vendimit nr. 74, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila me thënë të vërtetën është një çështje që na ka ardhur si pasojë e disa pasaktësive të bëra nga stafi në pjesën e hedhjes së shortit të delegimeve, gjë që na ka çuar tek rishikimi i vendimit të marrë në mbledhjen e kaluar, për anulimin e një pjese të shortit, për Gjykatën e Apelit Durrës.

Për më shumë detaje, fjalën ia kaloj sërish zotit Toska për relatimin e projekt-aktit.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, në datën 20.05.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor, trajtoi një sërë kërkesash të paraqitura nga gjykata të ndryshme, në lidhje me caktimin e gjyqtarëve për çështje gjyqësore të veçanta. Në kuadër të trajtimit të këtyre kërkesave, gabimisht janë përfshirë edhe dy kërkesa në fakt të Gjykatës së Apelit Durrës, që në fakt Këshilli i kishte trajtuar më herët që në mbledhjen e muajit mars të këtij viti, ku ka dalë me vendimin nr. 47 të datës 18 mars. Gjatë përpunimit, gabimisht është konsideruar që këto kërkesa të paraqitura më herët nga Gjykata e Apelit Durrës nuk ishin trajtuar, dhe u përfshinë sërish në trajtim. Në këto kushte, përderisa trajtimi i tyre është ezauruar, rezulton që kemi disponuar në mënyrë të gabuar në lidhje me caktimin përsëri të gjyqtarëve për këto dy kërkesa të Gjykatës së Apelit Durrës.

Ky fakt u konstatua menjëherë pas mbarimit të mbledhjes në momentin që duhej të zbardhej vendimi, dhe menjëherë përgatitëm një projektvendim, përmes të cilit Këshilli duhet të vendosë anulimin e paragrafit I, nënndarja ‘Gjykata e Apelit Durrës’ të vendimit nr. 74, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në këtë rast kemi propozuar që të hiqet dhe nga publikimi i faqes zyrtare, pikërisht të nënndarja ‘Gjykata e Apelit Durrës’, paragrafi i parë, për të mos shkaktuar konfuzitet, apo ndonjë situatë tjetër problematike më pas. Nëse ka ndonjë pyetje, mund të jap sqarim.

Naureda Llagami: Keni ndonjë pyetje, paqartësi?

Atëherë kalojmë projekt-aktin, projekt-vendimin në votim sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për anulimin pjesërisht të vendimit nr. 74, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor duke anuluar paragrafin I, nënndarja ‘Gjykata e Apelit Durrës’ të vendimit nr. 74 të datës 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Heqjen nga publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të paragrafit I, nënndarja ‘Gjykata e Apelit Durrës’, të vendimit nr. 74, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, duhet të bëj prezent dhe të konsiderohet nga ana e administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor se gjatë procedurave të shortit të datës 20, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë, gabimisht është përmendur gjatë mbledhjes numri 4 në fakt është numri 6, çështja numër 6 tek lista e çështjeve, kjo është thjesht për saktësi se procedurat janë në rregull, për të mos krijuar konfuzitet në zbardhjen e vendimit. Pra ku referohet 4, në fakt është numri 6. Sepse kjo është evidente sepse kërkohet 1 gjyqtar dhe 4-a në fakt kërkon dy gjyqtarë. Është gabuar në përmendjen e numrit. Është lapsus, kështu që administrata ta konsiderojë gjatë zbardhjes apo gjatë veprimeve të mëtejshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse keni ndonjë gjë tjetër?

Jo!

Atëherë mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Faleminderit për prezencën!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor